

Shpallje për Punë
INXHINIER NDËRTIMI

Punëdhënësi: NPK Moravica, Preshevë

Vendi: Preshevë

Ndërmarrja Publike Komunale Moravica shpallë konkurs për të punësuar një **Udhëheqës i Sektorit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit**. Udhëheqësi është i/e detyruar që të udhëheqë sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit me qëllim të menaxhimit të përgjithshëm të organizimit të këtij sektori.

Përshkrimi i punës:

- Udhëheqë, organizon, koordinon dhe është përgjegjës/e për punën në përgjithësi të grupeve operative për distribuimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Udhëheqë dhe organizon të gjitha punët në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm (menaxhimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit publik të furnizimit me ujë në Komunën e Preshevës);
- Udhëheqë dhe organizon të gjitha punët në lidhje me sistemin e kanalizimit (menaxhimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit publik të kanalizimit në Komunën e Preshevës);
- Udhëheqë zbatimin e masave për mbrojtjen nga përmbytjet si dhe formave tjera të mbrojtjes nga efektet e dëmshme për ujë të pijshëm, merr parasysh dhe siguron kushtet e përcaktuara me ligj (mbrojtja e higjienës dhe mbrojtjet tjera për të siguruar kualitetin e ujit të pijshëm);
- Raporton dhe informon rregullisht Drejtorin e NPK-së për të gjitha situatat në terren dhe mban të dhëna statistikore nga sfera e shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Mbikëqyrë punën e sektorit, edhe atë: pregatit vlerësimet dhe llogaritjet, siguron kërkesën dhe nevojat për materiale, udhëheqë të gjitha të dhënat dhe raportet e nevojshme të shërbimit, kujdeset dhe kontrollon punën e ekipit si dhe punët e kryera në terren, kujdeset për zbatimin e duhur të veprimeve dhe masave të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Ofron të punësuarve ndihmë teknike dhe profesionale;
- Me urdhër të drejtorit, kryen edhe detyra të tjera për menaxhimin dhe përmirësimin e punës së përgjithshme të NPKsë

Kushtet:

- Të ketë të përfunduar shkallën e VI ose VII të kualifikimit profesional, Fakulteti i Ndërtimtarisë (e preferuar por jo e kufizuar: drejtimi i hidroteknikës)
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës serbe
- Patent shoferi të kategorisë B,
- E preferuar përvoja e punës në rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, etj.
- Njohja e punës në kompjuter (MS office, ACAD software, etj.)

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë përmes CVsë duke bashkangjitur të dhënat tjera për të përmbushur kushtet e shpalljes (fotokopja e diplomës, fotokopja e leternjoftimit) përmes postës elektronike jp.np.moravica@hotmail.com ose personalisht tek zyret e NPK Moravica, rruga Q. Shehu pn, Preshevë.

Vetëm kandidatët të cilët përmbushin kushtet e paraqitura dhe hyjnë në rrethin e ngushtë do të kontaktohen .

Afati i konkurimit: 15 Gusht 2018.